

## Pse SYMBOLON?



Symbolon i ka rrënjët në thellësinë sekrete të qenies, pasi qenia vetë është Symbolon. Ai është ndërmjetësi që bën të panjohurën, të njohur. Si i tillë, më zbulon aspektet më të rëndësishme të realitetit tim, aspektet më të thella që i ikin çdo mjeti njohje. Pikturat e mia janë imazhet që flinin brenda meje. Të gjitha sëbashku qenë Symbolon. Unë e theva Symbolonin. I mora copëzat një e nga një, dhe i shoqërova nga skuta më e thellë e nënvetëdijes, në sipërfaqen e vetëdijes, ku dhe i ribashkova. Rikrijova Symbolonin. Është një proces ndarje dhe ribashkimi. Është proces rinjohje i vetvetes. Nuk më vjen

keq, që Symboloni i rikrijuar në sipërfaqe, nuk është identik me Symbolonin arketipal të thellësive të errëta, por është refleks shumë besnik i tij. Është një gënjeshtër e madhe... por jam artist, dhe si i tillë, zmadhoj rrezen e së vërtetës nëpërmjet saj. Ndoshta, ky është dimension i shenjtë i njeriut, zmadhimi i së vërtetës nëpërmjet gënjeshtres.

E vërteta dhe e pavërteta, janë SYMBOLON.

E tillë është piktura ime.

GAZMEND LEKA

Ky është teksti shoqërues në ekspozitën personale "SYMBOLON"  
çelur në Galerinë Kombëtare të Arteve.